



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.492/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.492/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë Vladimira Popovica 40A, Kati 54, Beograd-Serbi, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent, për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.492/2023 të datës 13.03.2023, të parashtruar nga ankuesi
- II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, me datë 11.03.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 13.03.2023 nën shenjë A.nr.492/2023, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2022 të datës 13.02.2023 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me dispozitat e ligjit material dhe legjislacionit të veçantë për shkak të shkeljeve procedurale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit me datë 07.04.2023 përmes Njësisë së Burimeve Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit e datës 13.03.2023 me Nr.Prot:2596/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i dërguar nga J.J drejtuar KPMSHCK i datës 13.03.2023; E-maili e dërguar nga Kabineti i MPJD drejtuar J.J i datës 10.02.2023; E-mailin dërguar nga J.J drejtuar KPMSHCK e datës 14.03.2023; Raporti Vjetor i Punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2022 me nr.ref.1/2023 i datës 26.01.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 07.04.2023; Draft Agjende për Konferencën e 6-të e Ambasadorëve, Lista e takimeve E-mailin e dërguar nga V.B drejtuar KPMSHCK e datës 03.04.2023; Flete kthesë; Akt emërim me numër 186 e datës 08.11.2016; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 13.02.2023; Vendim me nr.102/2009 i datës 23.11.2009; E-mailin e dërguar nga V.B drejtuar KPMSHCK i datës 18.04.2023; Dekret me nr.285/2019 i datës 31.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.492/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi Jetish Jashari, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 08.11.2016 ka qenë i emëruar pozitën "*Udhëheqës i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktatet*" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa në bazë të Dekretit me numër 285/2019 të datës 31.12.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës i njëjti është emëruar Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën e Serbisë, dhe në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 me datë 13.02.2023 nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.18.

Bazuar në provat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Dekretit me numër 285/2019 të datës 31.12.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, është emëruar Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën e Serbisë, në pajtim me nenin 84 paragrafi 4, 10 dhe 25 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin e Jashtëm, përkatësisht nenin 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "*7.1.Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret*".

Rrjedhimisht, me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 është përcaktuar se: 1. *Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: 2. *Funksionarë publikë, në kuptimin e nën paragrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2.*



anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura, nga rrjedh se të emëruarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, siç është rasti i ankuesit kanë statusin e funksionarit publikë dhe si rrjedhojë për shkak të këtij statusi janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të cekura si me lartë dhe duke marr parasysh se ankuesi me Dekretin me numër 285/2019 të datës 31.12.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, është i emëruar ambasador dhe se objekti ankimor ka të bëjë me vlerësimin e rezultateve të punës si pasojë e ushtrimit të këtij funksioni, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të Ambasadorit në Republikën e Serbisë nuk e ka statusin e nëpunësit civil, ngase i njëjti konsiderohet funksionar publikë për aq kohë sa Dekreti me numër 285/2019 i datës 31.12.2019 i Presidentit është në fuqi, dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë ekzistimit të kësaj gjendje statusore nuk ka kompetencë për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.492/2023 të datës 13.03.2023, sepse Këshilli sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit në këtë kontekst thekson faktin se në momentin që ankuesi lirohet nga detyra apo i përfundon mandati i funksionarit publikë i emëruar sipas dekretit presidencial, të njëjtit i linden të drejtat e parashikuara me legjislacionin e shërbimit civil, pasi që ankuesi para se të emërohej ambasador, sipas Aktit të Emërimit me numër:186 datës 08.11.2016 kishte statusin e nëpunësit civil që tani përcaktohet me nenin 2 paragraf 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 ndërlidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kështu që pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.492/2023 të datës 13.03.2023, statusit aktual të funksionarit publikë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Aktgjykimin në rastin nr. KI214/21 të datës 06.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.492/2023

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

